

TOLERANCA SI PRANIM I TJETRIT

Fjala tolerancë nuk është një fjalë shqipe. Ajo vjen nga gjuha angleze dhe fjala në shqip përkthehet durim, lejesë, butësi. A janë shqiptarët një popull tolerant? Historikisht mund të sillen shembuj, ku shqiptarët janë treguar vërtetë tolerantë, sidomos në mardhëniet me të huajt.

Shqiptarët kanë patur një fat të hidhur historik, ata asnjëherë nuk kanë ndërtuar një shoqëri të lirë. Ata mund të kenë qenë të lirë individualisht, por nuk kanë mundur të krijojnë një shoqëri të lirë. Trualli shqiptar ose ka qenë anarkik ose diktaturë, pra asnjëherë një truall demokratik. Toleranca është dukuri e shoqërive të lira, ku pranohet, respektohet, zhvillohet e ndryshmja jote.

Shqiptarët, duke e parë shtetin e pushtesit si armik, nuk arritën të zhvillojnë koncepte të drejta edhe për shtetin e tyre, kur iu ka dhënë rasti ta krijojnë atë. Është e njohur thënia e Faik Konicës se shqiptarët e krijuan shtetin e tyre, por nuk dinë se çfarë të bëjnë me të. Vijon në faqen 4

Intervistë me Z. Dritan Haznedari, Kryetar i Degës PD Berat.

A është konturuar portreti i kandidatit për kryetarin e Bashkisë së Beratit? Në zgjedhjet e vjeshtës do të dilni vetëm apo në koalicion me aleatët tuaj?

Aktualisht strukturat e PD-së janë të angazhuara në një proces intensiv evidentimi dhe seleksionimi të kandidaturave për kryetarë të njësive vendore po ashtu edhe për këshilltarë të këtyre njësive.

Mund t'ju them se ka një rivalitet kandidaturash dinjoze dhe shume përfaqesuese të cilat vijnë nga trupa politike e PD-së, si edhe nga ajo pjesë e shoqërisë e cila nuk ka patur ndonjë angazhim të fortë politik. Në cdo rast është patur parasysh, kjo kushtezohet edhe nga kriteret e vendosura, që kandidaturat të bartin vlera njerëzore, demokratike dhe profesionale.

Cili është imazhi i PD-se për qeverisjen vendore që do të dalë nga zgjedhjet e vjeshtës?

Ne do të sjellim imazhin e shpresës dhe të besimit, se ky vend, ky qytet mund t'i ofroje mundësi të mrekullueshme cdokujt që ka dëshirën dhe vullnetin për të punuar dhe investuar. Ne do të zhbëjmë imazhin ikanak dhe humbes që ka dominuar gjatë këtyre viteve. Ne do t'i kthejme ngjyrat qytetit tone që shfaqet ngado dhimbshëm "monokromatik".

Nëse përpiqem të them një opinion të përmbledhur se kush është imazhi i PD-së për qeverisjen vendore do të theksoja: Për vizionin tonë Bashkia nuk është dhe nuk duhet të jetë thjesht dhe vetëm një mbledhëse dhe prokuruese fondesh por, mbi të gjitha duhet të jetë orientuese dhe ideatore e strategjive të zhvillimit, krijuese e hapësirave oportune për investime, fantaziiste dhe frymëzuese e iniciativës së lirë, një hallkë shumë e rëndësishme integruese për komunitetin tonë.

Në konsideratën tone si forcë politike një vlerë të vecantë, sidomos në realitetin shqiptar merr transparenca. Transparenca ndaj publikut duhet të jetë një nga detyrat më impenjative për administratën dhe për të zgjedhurit në pushtetin lokal.

Në mënyrë të detajuar do të takojë kandidatit për kryetar bashkie ta zhvillojë këtë përgjigje.

Në zgjedhjet e vjeshtës do të dilni vetëm apo në koalicion me aleatët tuaj?

Partia Demokratike tashmë e ka bërë të qartë vullnetin e saj jo vetëm për të ruajtur koalicionin "Bashkimi për Fitore" por, edhe zgjerimin e tij me parti të tjera të spektrit të djathtë dhe qendrës së djathtë.

Formula e cila konsiston në daljen me një kandidat të përbashkët për kryetar dhe lista të vecanta për këshillat besoj se shmang copëzimin e elektoratit tonë, mbyll hapësirat për diversion dhe njëkohësisht nuk cënon motivimin dhe ambiciet e partive "të vogla" për zgjedhjet.

Berati me specifikën e tij, uzurpimin e skajshëm të pushtetit nga socialistët, e ka të domosdoshme daljen në koalicion për të retushuar pikërisht këtë imazh të perçudnuar dhunshëm rozë.

Gjykoj se, pavaresisht negociatave të partive në nivel qendror, ne duhet të mendojmë më lokalisht për koalicionet. Shumë shpejt në funksion të kësaj ideje Dega e PD-së Berat do të fillojë takimet bilaterale me partitë e tjera të spektrit të djathtë me qëllim vlerësimin e formave të bashkëpunimit në koalicion duke uruar tejkalimin e këtij niveli krahasuar me atë qendror.

Duke qenë drejtuesi kryesor i degës së partisë, e shihni veten si kandidat për kryetar të Bashkisë?

Vendimmarrja për përcaktimin e kandidaturës i takon me statut kryesisë së PD-së, unë si edhe cdo anëtar do të respektojme vendimet e këtij forumi.

Është shumë normale dhe logjike që pasi ke fituar një mandat politik, të pranosh të marrësh edhe përgjegjësinë e përfaqësimit në një kompeticion elektoral lokal.

Duke qenë se është prononcimi i parë në gazetën e re “Lajmëtari i Beratit”, dua që fillimisht t’i uroj gazetës , start të mbarë, emër dhe zë të mirë , në fushën mediatike, kontribut dhe rol aktiv në informimin e publikut, frymë realiste dhe pluraliste në faqet e saj, të jetë avokate e progresit dhe e zhvillimit, të jetë oponente dhe e papajtueshme me dukuritë dhe praktikat që ndalin përparimin, një zë më shumë për të vërtetën, një zë më shumë për të shëndoshur klimën demokratike të shoqërisë sonë, një zë më pak për deformim, keqinformim e komercializëm gazetaresk. Njëherazi ashtu siç besoj, se gazeta juaj do të jetë e hapur, edhe unë do të jem i hapurdhe i gatshëm të vihem në dispozicion të saj për t’u prononcuar publikisht.

A është konturuar portreti i kandidatit për kryetarin e Bashkisë së Beratit?

Sa për pyetjen që ju më drejtoni sot, mund t’ju them se strukturat dhe format e PS-së janë përfshirë në proces e përgatitje për zgjedhjet vendore dhe tashmë janë në fazën e propozimeve dhe të zgjedhjeve të kandidaturave për kryetarë bashkie e komune dhe këshilltarë. Cikli i përzgjedhjes në PS kalon në disa filtre, që fillojnë që nga organizatat, këshillat zonale të PS-së forumet e rrethit e më në fund eskuzivitetin e caktimit të kandidaturës përfundimtare e ka Kryesia e P.S.SH. Përsa i takon emrave për kryetarë bashkie dhe për kryetarë komunash besoj do të njiheni brenda muajit korrik, pasi jam duke mbyllur në rrugë institucionale procesin e përzgjedhjes në strukturat e bazës. Ajo që mund t’ju them paraprakisht është fakti se po shkohet drejt konturimit të portretit të kandidatit që do të përfaqësojë PS-në në dy bashkitë dhe në dhjetë komunitet. Gara përzgjedhëse brenda vetes përfshin shumë protagoniste dhe emra potentë konkures për fitues, dhe natyrshëm shumica e kandidatëve do të dali me konsensus brenda strukturave dhe forumeve të PS-së.

Cili është imazhi i PS-së për qeverisjen vendore që do të dalë nga zgjedhjet e vjeshtës?

-Besoj, është imazhi i një force politike sërish fituese me përfaqësim të vlerave më të mira të saj, me vullnet politik dhe shpenzim energjish për të vazhduar progresin e nisur, për të realizuar reformat e gjithanshme për të forcuar autoritetin e ligjit, për t’iu shërbyer qytetarëve, për të bashkëpunuar me opozitën dhe faktorët e tjerë me ndikim në jetën e komunitetit. Shkurt dhe thjesht: imazhi i PS-së është e do të jetë punë, veprim, ligj, vetkorrigjim, rezultat qeverisës, transparencë, bashkëpunim, e kontribut nga të gjithë ata që janë të dashuruar me qytetin e komunitetin; pra : plotësimi i detyrave që rrjedhin për një forcë politike mazhorancë.

Në zgjedhjet e vjeshtës do të dilni vetëm apo në koalicion me aleatët tuaj?

-Do të dalim me kandidatura me aleatët tanë. Kryesia e P.S.Sh-së është në fazën e konkretizimit të marrëveshjeve me PSD, PAD, PBDNJ, dhe PAA për mënyrën dhe modalitetet e këtij bashkëpunimi në zgjedhjet e Tetorit. Është

nënshkruar

vijon në faqen 3

Intervistë me znj.Fitore Sulejmani kandidate për kryetare bashkie, propozuar nga lëvizja “Mjaft”

U lind më 08.08.1953 në Dibër. Diplomuar më 1975 në Fakultetin Histori-Filologji në degën Anglisht. Është mësuese e gjuhës angleze në gjimnazin Babë Dudë Karbunara.

Koordinatorë dhe trainere e Organiatës Kombëtare të debatit. Lektore dhe trajnere Kombëtare.

Koordinatorë e programit të edukimit në shkollat e mesme “për zgjedhjen e konflikteve me ndërmjetësim në projektin: “Edukimi për Paqen”.

Trainere e OSBE-së në projektin “Të drejtat e gruas dhe edukimi anti-trafik.

Interesat profesionale

Psikologjia padoleshente. Psikologjia e të mësuarit.

Psikologjia rinore.

Zgjidhja e konflikteve

Ndërmjetësimi moshor

Aktivizmi rinor

Edukimi dhe arsimimi humanist.

-Të drejtat e fëmijëve dhe të drejtat e gruas.

Po kandidoni si sfidë ndaj malit me probleme të qytetarëve apo si sfidë ndaj malit me burra të partive?

Ndaj malit të problemeve jo. Problemet s'mund të sfidohen në kuptimin se ato s'mbarojnë kurrë. Një shtëpi ke dhe problemet i lënë vendin njëri-tjetrit. Sa mbyll problemin me çatinë, të prishet tubacioni. Pas tubacionit s'punon rubineti. Bie një rrufe dhe të djegë TV dhe frigoriferin. Mendon se mbaruan me kaq, kur të troket dera dhe fqinja thotë se po i pikon mbi kokë WC-ja jote. E mund të numëroj plot halle e telashe që s'kanë të sosur, ca që varen nga ti e ca që s'kanë lidhje fare me ty. Por të sfidosh problemet, për mua, do të thotë të bësh maksimumin, të duash vërtet t'i zgjidhësh. Prapa çdo sfide qëndron një dëshirë dhe motivim. Prapa çdo motivimi qëndron një veprim. Prapa çdo veprimi qëndron një ndryshim. Dhe prapa çdo ndryshimi qëndron një hap drejt progresit. Pastaj, vet jeta është një sfidë. Prandaj edhe ja vlen ta jetosh.

Ndaj burrave jo. Ruajna zot, sidomos ndaj burrave të politikës, që u është mbushur mendja se janë të pazëvendësueshëm. Nuk është çështje sfide. Çështja është se burrat dhe gratë përfaqësojnë aftësi, vlera, ide, kapacitete e këndvështrime të ndryshme. Shpesh diametralisht të kundërta. Ne, gratë, na "akuzojnë" se jemi emocionale, dhe kjo është e vërtetë në kuptimin që ne ndiejmë me pasion, përjetojmë me shumë ndjenjë dhe i kuptojmë të tjerët më me shumë thellësi. Na vlerësojnë si inteligjente nga natyra, me aftësi manaxheriale të lindura, me përkushtim mahnitës. Hidhni një sy familjes! Pesha më e madhe i bie gruas dhe të përballosh të gjitha vlerat dhe problemet e shumta që mbart familja, duhet shumë aftësi dhe inteligjencë, por edhe energji, që gratë i kanë me tonelata. Nëse familjes dhe shoqërisë do t'i mungonte gruaja, si njëra dhe tjetra do të shkërmoqeshin, do të thërmoheshin, do të funksiononin me shumë defekte.

Burrat i respektoj dhe i çmoj për ata çka ata janë. Ata janë partnerët dhe bashkëpunëtorët tanë. Ne kemi nevojë për mendjet e tyre, për vlerat e tyre, për kapacitetet e tyre, për inteligjencën e tyre. Pastaj, pse nuk pyesni në e kam sfidë ndaj kësaj apo asaj? E vetmja sfidë është ndaj mentaliteteve, psikologjive e mendësive që u lënë pak hapësira grave. Më shumë është vetiake, është pjesë e natyrës time energjike dhe shumë kërkuese. Më pëlqen të tentoj, të provoj, të testoj, të rrezikoj dhe, e gjithë kjo, s'është asgjë tjetër veçse pjesë e rritjes sime intelektuale dhe shpirtërore. Por për mua, përballja me burrat me një kandidaturë është dinjitoze një grua.

Partitë tashmë i kanë përcaktuar qartë kufijtë e parcelave të tyre elektorale. Cilat do të jetë "parcels" juaj?

E tmerrshme! Kur thoni parcela, më kujtohen kooperativat. Shpresoj që zgjedhjet të mos kthehen në kooperativa. Që të jem e sinqertë kam marrë një propozim nga drejtuesi i lëvizjes "Mjaft" të Beratit. Sidomos, të rinjtë e gjimnazit që ishin pjesa më aktive në të, e njohin mirë këtë lëvizje. Kujtoni pëllëmbën e hapur. Filozofia e lëvizjes është: Mjaft apatisë dhe mospjesëmarrjes qytetare, njerëz zgjohuni dhe i thoni mjaft gjakmarrjes, degradimit të sistemit arsimor dhe shëndetësor, mjaft rrugëve të prishura, mjaft vjedhjeve nga politikanë të korruptuar, mjaft abuzimeve, padrejtësive, mjaft krimet dhe kriminaliteti, mjaft trafikimit, korrupsionit, dhunës, degradimit të sistemit ekologjik, etj-etj, malit me probleme që ju përmendët në fillim.

Vizioni i lëvizjes është një vizion shumë modern dhe afatgjatë. Ai përkon edhe me vizionin tim vetiak se si duhet të funksionojnë gjërat. Për mua do të ishte fantastike që njerëzit të mësonin të organizoheshin, e përsëris të organizoheshin, të ngrinin zërin në malin e problemeve dhe jo t'ua lënë çdo gjë në dorë politikanëve. Pas lëvizjes "Mjaft" qëndron Lidhja Rinore Ballkanike dhe Qendra Kombëtare e Debatit. Që të përdorë termin tuaj, "parcels" ime përbëhet nga rinia shkollore dhe ajo universitare, por me filozofinë e lëvizjes është çdo shqiptar që i ka ardhur shpirti në majë të hundës dhe që e ndien që kësaj apatie frymëmarrëse i duhet dhënë fund. Personalisht mendoj se për mua ka ardhur koha që të kaloj nga pozicioni i konstatuesit dhe kritikuesit në atë të vepruesit.

Një mesazh për qytetarët e Beratit tani, kur fushata ende s'ka filluar.

Të gjithë qytetarët e Beratit janë mëse të sigurtë për standartet dhe vlerat që përfaqëson një grua. Edhe ju, personalisht, jeni mëse i ndërgjegjshëm, që gratë korruptohen më pak, gënjejnë më pak, vjedhin më pak, abuzojnë më pak, mashtrojnë më pak, bëjnë demagogji më pak, ashtu siç jeni i vetëdijshëm për vlerat e saj si dedikimin, përkushtimin, seriozitetin, vullnetin, kurajon, inteligjencën, kulturën dhe qytetarinë. Do të doja që këtë radhë beratasit t'i besonin një gruajë, që vjen nga shumica e heshtur por që mbart kapacitete të pashtershme, që mbart drejtësi dinjitet, dhe integritet, që ndien si ju, që vuan si ju, që stresohet dhe revoltohet si ju për padrejtësitë dhe prapësitë. Fatkeqësisht, unë nuk premtoj dot asgjë, por unë vë në dispozicion të njerëzve standartet e mia, ndershmërinë time, integritetin tim, lirinë time mendore dhe intelektuale, shpirtërore, diturinë time, kulturën time, gjithë kapacitetet e mia.

Intervistë me z. Fadil Nasufi, Kryetar i Degës PS Berat.

marrëveshja PSSH- PAA për dhjetë komuna në shkallë vendi dhe në rrethin tonë në komunën e Poshnjës kandidatura do të jetë PAA-PSSH. E njëjta marrëveshje është edhe midis PSSH dhe PAD për dhjetë njësi administrative. Vazhdojnë negociatat me PBDNJ, ndërsa me PSD nuk ka marrëveshje për kandidatë të përbashkët, por do të bashkëpunohet për çështje të tjera që i bashkojnë partitë tona si subjektet e të njëjtit spektër.

Duke qenë drejtues kryesor i degës së partisë e shihni veten si kandidat për kryetar bashkie? Në radhë të parë e shikoj veten si drejtues i PS-së që së bashku me forumet dhe ekipet tona përfaqësuese të organizojmë punën për t'i rifituar zgjedhjet. Ne kemi krijuar në këta 12 vjet një klasë politike vendore me përfaqësues që i përmbushim parametrat bashkëkohorë të përfaqësimit e drejtimit publik dhe që kanë dhënë prova të përgjegjshmërisë e të aftësisë për të drejtuar. Drejtuesi nuk është vetëm pjesë e konsumuar e pushtetit, por edhe investim politik,

administrativ, e menazherist që formohet me shumë mund. Në këtë kuptim, ka vazhdimësi mandatesh, por edhe rotacion për hir të konkurimit e përzgjedhjes së individëve më të votueshëm në elektorat. Kryetari i Partisë, në parim është më i promovuari për të qenë kandidaturë alternataive në zgjedhje vendore apo legislative brenda strukturave. Kjo do të thotë se loja është e hapur dhe shanse nuk ka vetëm një individ. Faleminderit!

Vijon nga faqja 2

Prag zgjedhjesh.

Diskutimet vazhdojnë brenda partive.

Thashethemet kanë mbetur pronë e medias dhe e kafeneve.

Ishte një mëngjes që ndillte vapë. Në një nga kafenetë e breglumit të qytetit tonë sa kishte nisur grindja e çdoditshme politike. Ishin ulur nëpër vendet e tyre, të parapëlqyera, rreth dy tavolinave, vendosur ballë për ballë njeri - tjetrit, në të njëjtin pozicion, ata të bregut të majtë të lumit dhe ata të bregut të djathtë të tij.

Ishin ende të përgjumur. Kishin zbritur nga zgafellat e tyre. Flisnin të gjithë. Pa njohur radhë. Pa prituri përgjigje. Qëndronin si të ishin mbi brigje të ndryshme të të njëjtit lumë. Pa urëlidhëse. Ashtu edhe po i lë. Të ndarë. Për t'u vendosur më shpenguar midis tyre.

Si zakonisht, fjalën të parët e morën ata të bregut të majtë. Se ata ishin në pushtet. Kishin më shumë siguri në ato që do të thoshin:

“Nga bregu ynë s’ka ende asgjë të re. Po dielli vazhdon të lindë gjithmonë për ne, nga lindja, s’ka asnjë re që t’ia zërë dritën. Bregu juaj le të presë ende perëdimin e tij.”

“Dielli juaj ka perënduar pa lindur. Po ju s’doni ta kuptoni”, përgjigjen aty për aty ata të bregut të djathtë.

“Nuk na e mbushni dot mendjen. S’keni asnjë argument që të na e vërtetoni. Kjo është thashemnjaja më e madhe që partitë tuaja po përdorin si argument këto kohët e fundit.”

“Doni agumente? A s’u mjafton grindja e madhe që ka shpërthyer në kreun e partisë suaj? A nuk janë akuzat e ndër-kombëtarëve për korrupsionin e push-tetarëve tuaj? A nuk po jua dokumenton lideri i partisë së bregut tonë çdo ditë? Doni më?...”

“Ato janë vetëm shpifje. Ju synoni të njollosni njerëzit tanë që t’u rrëmbeni votat votuesve. Po s’keni për t’ia arritur qëllimit. Ne dimë ta mbrojmë votën tonë. Njëherë na e hodhët. Nuk na e hidhni dot më. Kemi dhënë shembuj konkretë në këto zgjedhjet e fundit. Që ju i keni kontestuar. Se ne kemi në dorë edhe gurin, edhe arrën.

Andej nga partia jonë janë në hall të madh. Kemi shumë kuadro me përvojë dhe të zotë dhe ende nuk vendosim dot cilin të zgjedhin. Do të presim edhe ca ditë sa të shoshiten gjerat. Që të mbetet në fund kandidati i vetëm, ai më i zoti. Ne e kemi kurajon dhe mund t’jua numërojmë, po të doni, emrat e kandidatëve tanë të mundshëm...”

Dhe nisën t’i zinin me radhë emrat e atyre që përfoleshin si të propozuar.

Ata të bregut të djathtë nuk deshën të mbeteshin pas atyre të bregut të majtë. Se edhe ata kishin shumë intelektualë të zotë. Por, parapëlqyen të heshtnin. Siç duket, s’deshën të zbulonin sekretet e partive të tyre.

Po këto sekrete nuk mbetën pa u zbuluar. Ishte media që përgjon dhe zbulon këto thashetheme dhe ia servir popullit. Me ç’mision? Për t’i vënë në grindje kandidatët e përfolur? Për të shtuar hatërmbetjet e tyre? Apo kanë ndonjë qëllim tjetër?

Është stina e zgjedhjeve që po afron. Kjo stinë, me gjësimet dhe vetëtimat e pazakonshme, këtë detyrë kryen. Dhe ne si qytetarë këtu duhet t’i kërkojmë të vërtetat e këtyre thashethemeve. Jo gjetkë!... Agim Mehqemeja

OPOZITA NË BERAT KURRË S’KA MUNGUAR, ZOTI DEPUTET!

Në intervistën e z. Flamur Rogu, deputet i Kuvendit Popullor, në “Gazeta Tomori” krahas të tjerave shprehet edhe opiniononi : “ Kështu e sollli fati që ne kemi një mungesë totale të opozitës në qytetin e Beratit. Me sa duket s’ka fare opozitë...”

As që dua të korrigjoj konceptin e z. Rogu për opozitën dhe të qenit opozitar. Veçse më bën përshtypje megalomania me të cilën e vështron opozitën ky pozitar. Ai thotë se nuk ka opozitë. Ky konstatim është sa fyes aq edhe i pasaktë. Se kur thua s’ka opozitë, thua s’ka alternativë tjetër veç PS-së. Se kur thua s’ka opozitë, thua se në Berat pluralizmi ka vdekur, partitë nuk ekzistojnë, Këshilli i Bashkisë ka 35 këshilltarë të Partisë Socialiste, në Berat është vendosur diktatura, Partitë janë nxjerrë jashtë ligjit, njerëzit opozitarë kanë ikur nga qyteti, kanë emigruar të dëbuar nga një forcë madhore, intelektualët e djathtë ose janë larguar të gjithë ose kanë heshtur sepse ndihen të kërcënuar me bukën dhe me jetën. Kur thua s’ka opozitë, hedh poshtë tërë opinionin alternativ, thellësisht qytetarë dhe evropian të artikuluar fort dhe qartë nga Balil Gjini, Simon Vrusho, Dritan Haznedari, Fitore Sulejmani, Kastriot Dervishi etj, etj, etj, në faqet e shtypit qendror, tv-lokal, dhe në “Gazeta Tomori”. Kur thua s’ka opozitë hedh poshtë diskutimet, mendimet, propozimet, argumentimet ndryshe të bëra në Këshillin e Bashkisë së Beratit nga këshilltarët opozitarë: Milika Jaho, Dritan Haznedari, Astrit Qafa, Sali Hoxha etj. Kur

thua se në Berat nuk ka opozitë, e sheh Beratin si një fshat të thellë, tutje në Jug të Shqipërisë, ku kanë ikur të gjithë dhe kanë mbetur vetëm pesë shtëpi, rastësisht të gjitha përkrahëse të alternativës rozë. Kur thua se në Berat s'ka opozitë duket se e shikon Beratin si kopshtin tënd, ku nuk lulëzon asnjë bimë tjetër, përveç trëndafilave të kuq që aq shumë i ke për zemër. Kur thua se në Berat s'ka opozitë, fyen tërë strukturat demokratike (ende të dobëta), që me aq mundim po i ndërtojmë: këshillat e komunave, këshillat e bashkive, këshillin e qarkut, institucionet e tjera, partitë politike. Kur thua se në Berat s'ka opozitë, në radhë të parë godet Partinë Socialiste, pushtetin e saj që paska krijuar një klimë të tillë, ku opozita është shuar. Nëse e artikulon këtë mendim për shkaqe të fushatës elektorale, atëherë po e marrim thjesht si një lajthitje fushate e aq, por nëse ky është një perceptim fundamental, atëherë me trishtim e keqardhje ju kujtojmë se të qënit opozitarë nuk do të thotë veprime të dhunshme, por shprehje e mendimit ndryshe, për të gjitha problemet e komunitetit në institucione. Të qënit opozitar nuk është lufta klanore dhe denigrimi i tjetrit për shkaqe klasore apo në interes të klanit, por shprehja dhe artikulimi i interesave të qytetarëve.

Opozita asnjëherë nuk ka munguar, zotëri i nderuar deputet. Nuk është faj i saj që nuk dëgjohet, që nuk lexohet, që nuk shihet, pra nuk perceptohet.

Përfundoi kampionati vendor "Steka e Artë" 2003 **Engjëll Turku kampion**

Berati për dy ditë jetoi me atmosferën sportive të festës "Steka e Artë" 2003. Sportdashësit e shumë ndoqën në ministadiumin 600-vendësh lojërat e 16 "Stekave të Arta" të bilardistëve beratas, të vlefshme për kampionatin vendor. Më të mirët do të marin pjesë në kampionatin kombëtar që do të zhvillohet nga fundi i këtij muaji në Sarandë. Kampionati tregoi se bilardoja ka shumë dashamirës, madje, sipas një llogaritjeje të bëra, bilardistë ka më shumë se në çdo të dinë se bilardoja për Beratin nuk është sport i ri. Edhe në vitin 1936 është luajtur bilardoja në kafe-bufë "Burhani". Edhe lojës me 9 gurë, si kjo që u luajt në këtë kampionat, nuk i ka munguar bilardistët cilësorë. Disa prej të cilëve ka patur raste që e kanë filluar dhe mbaruar lojën pa e ndryshuar stekën nga dora. Të tillë kanë qenë: Gaqi Gjogu, Pali Deçolli, Abdul Kafexhiu, Kela Tavanxhiu, Namik Bode, Bujar Spahiu, Shyqyri Spahiu e deri tek trajneri i sotëm Engjëll Turku. Le të kthehemi te kampionati. Mbas ditës së parë, dotë e mbushur me lojëra të bukura dhe me rivalitet, pesë bilardistë pretendonin për titull. Në mesin e takimeve të ditës së dytë, numri i pretenduesve u bë në 3. Nga fundi i kësaj dite, Engjëll Turku (Lukja) mbeti i vetëm në krye duke u shpallur fitues i kampionatit. Kampioni u nderua me kupë, medalje dhe meroitoi shpërblimin 15-mijë lekë. Në vendin e dytë u rendit bilardisti i ri Ermal Kaçeli, që u shpërblye me 10 mijë lekë. Dhe në vendin e tretë Amarildo Seiti, që u shpërblye me 5 mijë lekë. U dalluan: Klodian Shanaj, Emiliano Idrizi, Lulëzim Frataraku. Kampionati përfundoi duke i lënë spektatorët të marin me vete mbresat e kujtimet për lojërat e bukura për mjedisin festiv, për nivelin e organizimit dhe të propagantimit, kjo për meritë edhe të punës që ka bërë trajneri Engjëll Turku të cilit i është gjetur pranë edhe ndihmesa e klubit shumësporteve "Tomori" dhe Bashkia Berat

Tregu fshatar në kushte skandaloze.

Të gjithë jemi mësuar që çdo të shtunë ta shohim të mbingarkuar kalimin nga lagja "Çlirim" për në qendër. Mes makinave që qarkullojnë nuk mungojnë nëpër rrugë dhe kafshët, karrocet që drejtohen për në lagjen "Goricë", ku gjendet "tregu fshatar", siç jemi mësuar ta quajmë. Ura shekullore e Goricës, eleganca e qytetit, është e para që mban mbi supe turmën e njerëzve, kafshëve dhe makinave shumëtonëshe. Në ditët me diell, në këmbët e kësaj ure buzë lumit Osum, tregtarët tregtojnë mes pluhurit ushqime duke filluar nga bulmetrat e fruta perimet. Në këtë treg nuk përdoren as vendet e posaçme për mallrat, aq më pak reklamimi i tyre. Duket absurde por gjithçka tregtohet mbi trasta, kartona e arka, ndonëse janë ushqime të përditshme. Konsumatorët i gëzohen çmimeve, që duke u krahasuar me ato të dyqaneve dhe merkatove, janë më të lira. Në këtë treg tregtohen bashkë me rrobat e vjetra, artikuj bulmetorë, ushqimet e kafshëve dhe gjëta e gjalla. Në ditët e nxehta të kësaj vere është e pashmangshme prishja e ushqimeve aq më tepër kur ato qëndrojnë me orë të tëra në diell mes pluhurit dhe insekteve. Kjo mënyrë skandaloze e të ushtruarit të tregëtisë është aq e rrezikshme për shëndetin e konsumatorit. Tregtarët nga ana e tyre shprehen se vendi ku ushtrojnë tregtinë, është i papërshtatshëm, por, është i vetmi vend që është zgjedhur nga ana e Bashkisë. Ata shprehen se paguajnë detyrimin ndaj këtij institucioni dhe punojnë në kushte të vështira dhe të papëlqyeshme nga ana e konsumatorit. Ndërsa këta të fundit thonë se kushtet i detyrojnë të blejnë ushqimet e përditshme në këtë treg për arsyen e vetme se tregtohen më lirë. Kushtet e këtij tregu përbëjnë një rrezik të hapur për qytetarët që konsumojnë artikujt që i tregtojnë aty.

Nuk përballonte dot jetën.

Vetmbytet në rezervuarin e fshatit të lindjes 53-vjeçar.

Pa kaluar as një javë nga publikimi i lajmit “Vetvrasja, largimi ...” në faqet e gazetës sonë, një tjetër vetvrasje është regjistruar në një fshat të këtij rrethi. Ngjarja ka ndodhur pasditen e ditës së premte në fshatin Tërpan, rreth 25 km larg Beratit. Ismail Hysaj, lindur në këtë fshat dhe banues në qytetin e Lushnjes, ka zgjedhur rezervuarin e fshatit të lindjes për t’i dhënë fund jetës. Burime që i referohen vendngjarjes, bëjnë të ditur se 53-vjeçari, babai i katër fëmijëve, kishte mbërritur në fshatin e tij. Ai dhe familja prej dy vjetësh kishin braktisur fshatin për t’u vendosur në qytetin e Lushnjes për një jetë më të mirë. Ditën e premte ai kishte mbërritur në fshat jo për të takuar vëllanë dhe bashkëfshatarët por për t’i dhënë fund jetës. Pasi ka mbërritur në vendlindje, ai i është drejtuar rezervuarit ku është vetmbytur. Lajmi është mësuar me shpejtësi nga të gjithë banorët e fshatit, të cilët janë vëvnë në ndihmë. Por ka qenë e pamundur t’i shpëtohej jeta. Rreth orës 19.30 është bërë e mundur nxjerrja e trupit të 53-vjeçarit nga uji. Në vendngjarje ka mbërritur grupi hetimor dhe mjeku ligjor që kanë kryer hetimet për këtë ngjarje. Nga hetimet e para dhe pohimet e familjarëve mësohet se 53-vjeçari është vetmbytur në kushte të rënda të depresionit nervor. Sipas familjarëve shpërngulja në qytetin e Lushnjes nuk kishte shkuar sipas parashikimeve. Ai dhe familja e tij kishin rënë pre e borxheve për të mbijetuar, ngaqë kishte qenë i papunë. Këto probleme të pakapërcyeshme për kryefamiljarin i morën atij jetën. Vetmbytia e tij çon në 17 numrin e të vetvrasjeve në këtë rreth këto kohët e fundit.

Fatmir Berati

Në për kujtim të Një martirjeje

Përsiatje

Një tufë lule te busti i Margaritës

Tashmë është bërë traditë që përvjetorët e rënies së dëshmorëve të kenë një datë të përbashkët. Si ai që u vra në majin e vitit 1942 dhe ata, motër e vëlla, që u ekzekutuan në korrikun e vitit 1943, apo ata, dy vëllezër, në 1 shtatorin e vitit 1943, të tjerë në betejat në luftë kundër fashizmit për lirinë e vendit, përkujtohen në 5 Majin, ditën kur ra Qemal Stafa, mbase edhe i tradhtuar, sikurse shumë të tjerë pas tij. Por ka edhe përvjetorë të veçantë jubilarë për dëshmorët -heronj, siç 60-vjetori i rënies së Margaritës më 6 korrik të këtij viti.

Kaloj çdo ditë para bustit të Margaritës. Shpesh-herë ndalem dhe përqëndrohem. Më duket sikur prapa shpinës së saj shoh edhe figurën e Kristaqit, të Ajetit, pse jo, edhe të Namikut e të Resulit, se ata ishin shokë të një ideali utopik, që i zhgënjeu, dhe mbase i tradhtuar.

E kam njohur nga afër Margaritën. Edhe sot kam të freskët fytyrën e saj shumë të bukur, sytë e saj të qeshur, që rrezatonin dritë e dashuri, të qeshurën e saj plot ëmbëlsi, ndiej farfuritjen e fustanit të saj që dukej sikur shpërndante aromë jargavani dhe ende ndiej jehonën e takave të saj në rrugicat e Mangalemit, të Muratçelepiasit e të Goricës, në të përpjetën e Kalasë, të cilat ajo i njihte më mirë se kushdo. Më duket sikur e shoh tek hyn në shtëpinë e Vahide Myftiut (kryetarja e parë e gruas antifashiste, bashkëshortja e Hamit Myftiut, ekzekutuar më 1948.), të Sanije Gjergjani aktiviste e shquar si dhe e para (bashkëshortja e Adem Gjergjanit).

Askush nuk mund t’i afrohej Margaritës, në ato vite, për nga bukuria, humanizmi, përkushtimi i saj. Natyra i kishte dhuruar intelektin, por edhe aftësinë e komunikimit. Ëmbëlsia e fjalës së saj, besimi për një të ardhme të begatë të vendit pa pushtues, kishin pushtuar zemrat e vajzave dhe grave të Beratit, të cilat e “pranuan” atë si pjesëtare të familjeve të tyre. Prandaj në ato vite thuhej se Margarita ku ngrysej, nuk gdhihej. Intensiteti i veprimtarisë së saj ia rriti shumë shpejt moshën. Busti i saj sot qëndron meritueshëm përballë bustit të atdhetarit Babë Dudë Karbunara.

Shqiptarizma e saj, që shpërtheu qyshkur kaloi pragun e rinisë pranë institutit femëror “Nëna Mbretëreshë” në Tiranë, urrejtja kundër pushtuesit fashist dhe përkushtimi deri në vetmohim ndaj pushtuesit, ishin shprehje të dashurisë së saj për lirinë dhe demokracinë. Dy kronika nga Eniela Azizelli Hiallin e Tutulanëve, ishin ushqyer me qumështin e nënës nga dera e nderuar e Haxhistasëve në Berat. Asaj nuk i munguan as 7 muajt e parë, as 7 vjetët e parë të edukimit familjar. Sepse është mjedisi familjar ku mbillen, kultivohen dhe hedhin rrënjë cilësitë më të mira të karakterit të njeriut. Humanizmi, dashuria për njeriun pa dallime, atdhedashuria, Margaritën e shndërruan, gjatë atyre viteve, në një adhuresë “xhelozë” të virtuteve të atdhedashurisë, por edhe në një simbol të luftës për liri, që të impononte respekt.

Duke vërejtur bustin e Margaritës mendimi më kthen mbrapa dhe bën që zemra të më mbushet me urrejtje ndaj atyre që, duke qenë të pafuqishëm për të shuar fjalën e saj, zërin e saj, zgjedhën mënyrën më çnjerëzore: zhdukjen fizike të saj dhe të vëllait të saj.

Tradhti mizore e ka emrin vepra e atyre që, të verbuar nga madhështia e kësaj vajze 18-vjeçare, i morën jetën në kulmin e lulëzimit të saj.

Si nuk u drodh ajo dorë gjakatare kur derdhi breshëri plumbash mbi trupat e tyre. Parafytyrimi para bustit është aq i fuqishëm, saqë, duke vërejtur atë, më duket se kërkoj të zbuloj aty gjurmët e plumbave.

Ku të ketë shënuar i mallkuari? Në fytyrën e saj engjëjllore apo në zemrën e vashës, zanë mali? Po Margarita, në çastin kur kaloi pragun e kësaj bote dhe u ngjit në Olimp për të zënë vendin e perëndeshës Venus, ku e çoi mendimi i vet? Te vëllai i dashur, Kristaqi, tek ëndërrat e saj të parrealizuara të moshës së rinisë, tek ideali të cilit iu përkushtua deri në vetmohim, apo tek të tria bashkë?

Busti i Margaritës edhe i heronjve të tjerë të luftës hedhin dritë mbi fillimet e lëvizjes komuniste në Shqipëri. Atë e përfaqëuan studentët jashtë shtetit si dhe nxënësit e shkollave. Ndër të parët qenë nxënësit e gjimnazit të Korçës, nxënëset e institutit femëror “Nëna Mbretëreshë” dhe nxënësit e gjimnazit të Tiranës, të Shkodrës, të Gjirokastrës dhe të tregtares së Vlorës. Ishte kjo elita e djalërisë shqiptare, pjesa më e përparuar dhe më e ndjeshme e shoqërisë. Por duhet theksuar se në atë kohë mundësi për të ndjekur shkollën e kishin vetëm bijtë e bijat e intelektualëve dhe të borgjezisë së asaj kohe, që më vonë u etiketua, u trajtua dhe u godit si shtresa më reaksionare e tradhtarë e shoqërisë.

Në këto familje ishte ngulitur ndjenja e atdhe-dashurisë, e respektit për flamurin kombëtar si simbol i lirisë dhe i pavarësisë. Atëherë ishte bërë edukatë që sa herë këndohej apo ekze-kutohej Himni i Flamurit, i madh e i vogël që nga nxënësit e shkollës fillore, të gjithë qëndronin në këmbë si të ngrirë, pa përpëlitur as qerpikët derisa të përfundonte himni. Mbi këtë taban të na-cionalizmit u ngrit në mënyrë diabolike e me demagogji kështjella 45-vjeçare e interna-cionalizmit proletar. Ishte Qemali, Nakua, Kristaqi e sa e sa të tjerë bij intelektualësh e borgjezësh, që ndërprejnë dhe braktisën studimet jashtë shtetit, u kthyen në atdhe për t’iu përkushtuar çështjes së çlirimit.

Por kishte edhe elementë të përshtatshëm e të përpunueshëm nga agjenturat e huaja antishqiptare e, që më vonë, të veshur me pushtet, zhdukën vlerat e kombit, personalitete të pasluftës, prindër e të afërm të këtyre heronjve si dhe personalitete të tjera të pasluftës, bashkëluftëtarë të tyre, të cilët i internuan, i ekzekutuan, hodhn baltë mbi figurat e tyre.

Gjithsesi, një pjesë e të rinjve të shkolluar apo edhe intelektualë të mirëfilltë të viteve të Luftës së dytë Botërore, ranë pre e demagogjisë së komunizmit “aziatik”. Ata u shndërruan në instrument të dobishëm, të cilët komunizmi i venosur në Shqipëri mundi ta shfrytëzojë për qëllimet e veta. Kjo përbënte thelbin e strategjisë së ko-munizmit.

Sipas fjalëve të Leninit kjo kategori njerëzish ishin “idiotët e vlefshëm, që si fillim, mund të përdoreshin për t’i shërbyer kauzës në mënyrë të pavetëdijshme. Më vonë gjërat do të ndryshonin. Në fillim do të ishte plori i parmendës, më vonë, kur të piqeshin kushtet, ky pluar do të farkëtohej dhe transformohej në një shpatë lufte.” (N.S.)

Në këtë kategori njerëzish përfshihej edhe Margarita, edhe Kristaqi. Po ata ikën shpejt dhe nuk provuan shijen e hidhur të zhgënjimit e të tradhtisë së idealit, të cilit i besuan si idealistë.

Nuk ka ideal pa idealistë, nuk ka idealistë pa përkushtim dhe nuk ka përkushtim pa të vetsakrifikuar. Këta janë dëshmorët tanë të parë, ndër ta edhe heronjtë e pavdekshëm të të gjitha periudhave historike.

Nuk ka asnjë dyshim se edhe Margarita, shpejt ose vonë, do të kishte ndjekur fatin e bashkëluftëtareve të saj: Ramize Gjebresë, të Drita Kosturit, të Liri Belishovës apo dhe të Svetllana Markut, të Flora Dëshnicës... E lista s’ka të sosur, sepse të gjitha këto ishin luftëtare afërsisht të një moshe dhe të një kalibri.

Por Margarita paska qenë e zgjedhura e Zeusit mitologjik për ta vendosur në Olimp në stolin e Venusit, se ajo edhe në botën reale, për aq vite sa jetoi, dalngadalë u shndërrua në një Venus e prekshme dhe që atëherë e pavdekshme.

Shkrova këto rreshta, në vend të një tufë lulesh te busti i Margaritës, në ditën e 60-vjetorit të rënies.

Berat, 21 qershor 2003.

Valter Shtylla

Ura të hershme në Berat

Fragment

Urat e hershme në Berat dhe në Skrapar lidhen kryesisht me arterjet rrugore antiko -mesjetare që kanë përshkuar luginën e lumit Osum. Mjaft fortifikime antiko - mesjetare si dhe ura mbi lumenj e përrrenj dëshmojnë se rrugët e luginës së Osumit kanë funksionuar që prej antikitetit e në vazhdim gjatë mesjetës.

Në antikitet luginë e Osumit lidhej me bregdetin dhe pikërisht me portet e Durrësit dhe të Vlorës nëpërmjet disa rrugëve. Nëpër urën e Kuçit mbi Seman, nga e cila ruhen ende gjurmët e urës antike, kalonte rruga që lidhte luginën me Durrësin. Ndërsa me Vlorën luginë e Osumit lidhej nëpërmjet rrugës fushore të Apollonisë -Roskovecit dhe asaj kodrinore nga Ballshi e Sinja. Ekzistenca e fortifikimeve antike të vona dhe mesjetare dëshmojnë se rrugët e luginës së Osumit kanë pasur rëndësi të veçantë dhe gjatë mesjetës.

Ura e parë gjatë luginës së Osumit e rrugës fushore Vlorë-Berat është ajo e fshatit Poshnjë, sot pa funksion, e njohur me emrin ura e Kaurit, ose e Frëngut. Ura e Poshnjës përbëhet nga një qemer tullash me hapësirë drite 5m. Me analogji datohet si ndërtim i shekujve V-VI, duke qenë kështu e vetmja urë e ruajtur e kësaj kohe.

Pas Poshnjës rruga fushore takon lumin e Osumit në vendin e quajtur sot Ura Vajgurore. Këtu në mesjetën e vonë rruga e hidhte lumin mbi një urë guri me qemere, ndërtimin e së cilës e filloi Ahmet Kurd Pasha në mesin e shekullit të XVIII dhe e përfundoi Ibrahim Pashë Vlorë në vitin 1800. Deri në vitin 1918, kur ura u dëmtua, ajo mbante emrin e Hasan Beut, i cili pat bërë riparimin e saj në vitin 1860. Në këtë vend rreth 200- 300m mbi urën e sotme të betonit ruhen gjurmët e një ure tjetër prej guri, ndoshta më e vjetër se ajo e Hasan Beut.

Në dokumenta të shekullit të XIII rezultojnë se në Berat mbi Osum nuk kishte urë, por lumi kalohej me trap.Në shekullin e XVII ura e Goricës përmendet për herë të parë nga Çelebiu që shkruan: “Ura e goricës ka nëntë harqe mbi tetë këmbëza druri të ngulura thellë në ujë dhe me dy këmbëza të forta anëve. Sipër është shtruar me trarë të thatë dushku të prerë në malin e Thatë”. Më vonë në vitin 1777 ura e Goricës u ndërtua me qemere guri nga sundimtari vendas Ahmet Kurd Pasha, siç dëshmon qemeri i parë i majtë. Në dhjetor 1888 ura e Goricës u rrëzua nga prurjet katastrofike të Osumit. Një dështim të dytë ura e pësoi gjatë Luftës së Parë Botërore. Sot ura e goricës vjen pas riparimeve të kryera në mbarimin e Luftës së Dytë

Botërore. Përveç të tjerave ura e Goricës lidhte Beratin me rrugën majtas Osumit, e cila kalonte nëpër Bilçë-Malinat-Tozhar-Palec. Këtu takonte përroin e Ujit të Zi, të cilin e kalonte mbi urën e Palecit (shek.XVII), sot e dëmtuar.

Rruga mesjetare kodrinore Vlorë-Berat, nga Qafa e Sinjës, gjatë saj kishte dy ura guri. Në Sinjë ajo kalonte përroin e Mbeshovës mbi një urë, sot e prishur. Rruga para hyrjes në Berat e kalonte lumin e Velabishtit mbi një urë me tre qemere guri. Ura e Velabishtit është ndërtuar në mesin e shekullit XVIII nga Ismail Pashë Velabishti, sundimtari i sanxhaqeve të Vlorës e Delvinës. Ura e Velabishtit nga pikëpamja kompo-zicionale është pothuajse simetrike. Në kyçin e qemerit kryesor varet një copë zinxhir kuu kka qenë një këmbanë, e cila duke u tundur kur frynte erë e fortë paralajmëronte udhëtarët që të mos kalonin mbi urë se mund të rrëzoheshin. Pas Velabishtit rruga kordinore e Vlorës nga Qafë Sinja vazhdon disa qindra metra për të hyrë në Berat. Në bregun e majtë të Osumit, rreth 50m poshtë digës kapërdredhëse të betonit, ruhen disa blloqe gëlqerore të papunuara e pallaç, që dëshmojnë se këtu në antikitet, apo antikitetin e vonë duhet të ketë qenë ndonjë ndërtim lumor. Ndoshta gjatë antikitetit në Osum nuk ka pasur urë dhe kalimi nga një breg në tjetrin bëhej me trap; pasi këto gjurmë duken më tepër si skelë lumore, ose pontil për trapin.

Nga rrugët e luginës së Osumit shkëputeshin dhe degëzime që lidhnin luginën me krahina të tjera, si në fshatin Vokopolë, nga rruga majtas Osumit me luginën e Vjosës. Në Vokopolë mbi përroin e Çorogjafit ndodhet një urë guri mbi një qemer të lartë me dy dritare shkarkuese anash. Ura në mbështetjen e majtë nga ana e poshtme ka pasur një kamare me mbishkrim. ku qe shkruar viti 763 i ndërtimit të urës. Në zonën e Tomoricës ku kalonin rrugët mesjetare të karvanëve që lidhnin Beratin me Korçën, ndodhet fshati Grëmsh, vendlindja e arkitekt Kasemit, kryearkitekt i Perandorisë Osmane në mesin e shek.XVII. Nga Grëmshi ka pas kaluar njëra nga rrugët që lidhte Berat -Skraparin me Korçën.

Veç urave që përmendëm, në zonën e Beratit , është dhe një urë tjetër, ura e Bardhë mbi përroin e Zagorës, që lidh fshatin Duhanas me Beratin. Ura e Bardhë përbëhet ng anjë qemer i vetëm gjysëm rrethor, anash të cilit në lartësi janë dy dritare shkarkuese. Kjo urë duhet të jetë ndërtuar gjatë shek.XVIII.

“Monumentet”, 2, 1990 faqe 79-80.

Fatmir Berati

Epitafi i Gllavenicës dhe Anastas Goxhomani

Në vitin 1940 Anastas Go-xhomani kryente fun-ksionet e sekretarit të Bashkisë së Beratit, Kryetar ishte Yzedin Vrioni. Berati histo-rikisht është i njohur si rajon me kulturë të lashtë. Këtu ruheshin vepra me vlera të mëdha artistike, që hedhin dritë mbi historinë e lavdishme të krahinës dhe më gjerë. Kjo është një nga arsytet që ka nxitur lakminë e të huajve për t’i përvetësuar këto vlera me rrugë nga më të ndryshmet. Grabitja, kurthet, kompromentimi, premtimi me shuma të mëdha parash për të korruptuar personalitete të atyre viteve që, këta të fundit, t’u krijonin mundësinë ose të paktën të mos i pengonin për të shtënë në dorë dokumente origjinale me vlera artistike e historike për vendin tonë dhe pastaj t’i paraqitnin si krijime të tyre. Fallsifikatorë të historisë, uzurpatorë të huaj, por fatkeqësisht edhe shqiptarë, ka patur në çdo periudhë, mbase ka dhe sot. Por ka patur edhe burra patriotë e bij patriotësh, që, mbi çdo vlerë materiale, çmonin vlerat e kombit, historinë e tij të lavdishme. I tillë ishte Anastas Goxhomani, sekretari i Bashkisë së Beratit. I tillë u tregua ky burrë, qytetar beratas, kur një delegacion Episkopal i kishës Ortodokse, i nisur nga Greqia më 1939 dhe pas tij (meqenëse i pari me sa duket nuk pati sukses), pak më vonë, një delegacion Apostolik zbarkuan në Berat për t’u bërë zotër të Epitafit të Gllavenicës. Ata iu drejtua jo kryetarit, por sekretarit të Bashkisë, se kryetari ishte musliman, kurse sekretari i krishter. “Ata i premtuan një shumë të madhe parash dhe me djallëzi, për ta joshur, hapën një çantë me florinj mbi tryezën e kryesekretarit për të qëndisur një kopje të saj, i premtuan edhe bekimin e Episkopatit apo të Apostulatit në këmbim të “Epitafit të Gllavenicës”, shprehet Llambi Goxhomani (i riu). Por Cac Goxhomani i Beratit, vërtet ishte i krishterë, por ishte i krishter shqiptar e bir shqiptari. Ishte pasardhës i Rilindasve për të cilët “Feja e shqiptarit është shqiptaria”. Me sa duket ata nuk e njihnin mirë Cac Goxhomanin, nuk e njihnin atdhetarinë e tij, as veprimtarinë e tij patriotike dhe aq më pak erudicionin e tij. Ata trokitën gabimisht në portën e Anastas Goxhomanit, se me siguri nuk e njihnin karakterin e tij të pathyeshëm. Ata nuk e dinin se Anastas Goxhomani ishte nga ata burra, që e dinë mirë se vetëm një hap e ndan kurorën e lavdisë nga njolla e turpit. Dhe jeta e ka provuar se këtë hap që duhet hedhur, si duhet hedhur dhe kur duhet hedhur shpesh herë e përcakton jo rastësia. Vendime për të hedhur një hap të tillë, gjatë të gjithë jetës, njeriut mund t’i paraqiten vetëm njëherë. Dhe Caci ynë, bir i patriotit të shquar Llamb Goxhomanit (i vjetri), diti ta hedhë i sigurtë, pa mëdyshje këtë hap. Se mendja, zemra e shpirti i tij ishin prej atij brumi të ardhur, gatuar me majanë e trashëguar brez pas brezi në truallin e Gozhomanëve të Beratit. Për këtë arsye, të dërguarit e Athinës e të Vatikanit morën përgjigjen dinjitoze të Cacit tonë: “Epitafi i Gllavenicës është qëndisur nga dorë artisti shqiptar, ai është dokument i historisë së lavdishme të kombit tonë, është krijimtari e shpirtit prej artisti të

shqiptarit dhe shqiptari as e pranon, as e lejon, as mund të shesë nderin dhe shpirtin e kombit të vet”.
Dhe tradita vazhdon. Bijtë e Anastas Goxhomanit, Llambi Goxhomani (i riu) dhe Petraq Goxhomani, duke ndjekur gjurmët e paraardhësve të tyre, janë sot model i përkushtimit ndaj moralit dhe kultit fetar, përkushtim jo fitimprurës, por përkushtim në emër të lartësisimit të virtyteve njerëzore dhe pse jo të vlerave të kulturës së Beratit. Shembulli më i freskët është nisma që ata morën të dy bashkarisht, për të shtruar me krahët e tyre, me djersën e tyre rrugën që të shpie nga Mangalemi tek kisha e Shën Mëhillit atje poshtë shkëmbit , nën Tabien e Kalasë.Me përkushtimin e tyre ia “kthyen” Beratit këtë monument kulture duke e bërë lehtësisht të njohur për vizitorët vendas e të huaj. Ky veprim i vëllëzërve është për t’u përgëzuar nga idhtarët e kultit ortodoks, por më shumë si një gjest qytetarie beratase.

Fjala epitaf do të thotë mbishkrim mbi një varr. Por epitafi i Gllavenicës përfaqëson një vepër të rrallë artistike me përmbajtje fetare dhe me vlerë historike.Është një pëlhurë me përmasa 250 x 117 cm, e përforcuar me një astar. Me fije mëndafshi, ari dhe argjendi është qëndisur Krishti i shtrirë, Maria dhe Joani si dhe ëngjëj krahëhapur në fluturim.Është qëndisur edhe mbishkrimi (epitafai) në greqishten e vjetër, ku sipas Anastas Goxhomanit është përkthyer kështu: : “U plotësua i gjith-ëndëshmi dhe hyjnor i të mbishenjtës në muajin Mars 22 (K-B) S.U.I I. 6881. O ti që mban jetën, mjerisht si vdes, pa frymë qëndron:” Pra Epitafi i Gllavenicës përfaqëson varrin e Jezu Krishtit. Është një vepër artistike që i përket fundit të shekullit të XIV dhe si e tillë edhe me vlera historike. Sipas z. Shorka Dhamo, Epitafi është “dhuruar në manastirin e Ballshit nga feudalët katolikë Gjergj dhe Balsha, “të cilët ... kërkonin ti siguronin përkrahjen e popullsisë ortodokse të Shqipërisë së Mesme. (shih Fjalori Enciklopedik Shqiptar faqe 242). Këtu e ka burimin edhe këmbëngulja dashakeqe e të huajve për t’a përvetësuar Epitafin e Gllavenicës, për vlerat e saj artistike dhe sidomos historike, me qëllime të caktuara. Kumbimi i atyre këmbanave nga përtej kufijve ndihet edhe në ditët tona. Dhe historia mijëra vjeçare e vendit tonë i lë pa përgjigje pyetjet:

“Të jesh e lakmuar është fat apo fatkeqësi?

Pozicioni gjeografik, relievi, klima e vendit tonë, burimet tokësore e nëntokësore, këto dhurata të natyrës e bëjnë këtë vend të begatë apo të varfër?

Po shqiptari, që lindi në këtë truall duhet t’a quajë veten të lumtur apo fatkeq?

Po prania e gjitonëve europianë pranë kufijve tanë, drejt të cilëve shqiptarët marrin arratinë, a është fat apo fatkeqësi?

Këtyre pyetjeve dhe të tjera që lidhen me to, historia ende nuk i ka dhënë përgjigje të prerë.Deri kur?! Ndërsa politikanët, që bëjnë historinë me fatet e kombit, vazhdojnë të luajnë ende cingla. Deri kur?!”

(Vijon në numrin e ardhshëm)

Agim Mehqemeja

1.

vijon nga numri i kaluar

POETË BERATAS NË SHEKUI

MUÇI ZADE

“Poeti më i vjetër

beratas i letërsisë, shqipe”,

Dhimitër Shuteriqi.

Është poeti më i vjetër, i njohur deri më sot, që hapi udhën e letërsisë shqipe me alfabet arab. **Dhimitër Shuteriqi** e dallon si poet beratas. 1) Jetoj në midiset e shekujve XVII-XVIII. E quante veten i biri i **Muçit**. Mund të kemi të bëjmë, në këtë rast, me një pseudonim letrar të tij ose me një emër të përdorur në popull. Kemi prej tij vetëm një poezi-lutje, drejtuar Perëndisë, si adhures i kafesë, shkruar në vitin 1337 (1725). Poezia ka 17 strofa. 2) Ajo, vende-vende, tingëllon si një parodi. Pëmes një humori të hollë ne njihemi edhe me jetën e përkorë të poetit. Shkathtësia e vargut, na bën të mendojmë se autori jo vetëm ka trashëguar një traditë më të hershme të lëvrimin të poezisë shqipe, por edhe ai vetë ka fituar një përvojë në lëvrimin e kësaj poezie.

1. **Dhimitër Shuteriqi, “Autorë dhe tekste”, Tiranë, 1977, faqe 104.**

2. **Osman Myderrizi, “Letërsia shqipe me alfabet arab”, në “Buletin i shkencave shoqërore”, 2, 1955.**

IMZOT, MOS MË LËRË PA KAVE

Për sa rrëfejnë myxhizatë, 1)
për shenjtërit që janë vatë,
mos më le bë iftar thatë,
Imzot, mos më lerë pa kave!

Për hyrmet të Fatimesë, 2)
për të mirët e Merjemesë, 3)
mos më lerë me lëng
t’armesë,
Imzot, mos më lerë pa kave!

Imzot, mos më le të kujdes,
lë iftar me mjaltë pa pekmes
o Imzot, prej teje shpresë...!
Imzot, mos më lerë pa kave!

Dë këtë muaj mubareq 4)
falna gjynahet, se jemi pleq,
për gjithë sa janë meleq, 5)
Imzot, mos na lerë pa kave!

Për ismitë që je gafur 6)
për Muhamednë q'është meshhur 7)
mos më lerë po me bullgur...!
Imzot, mos më lerë pa kave!

Lutiu Zotit, Muçi Zade, 8)
se heq bari shumë derde,
se s'ke as pilaf as zerde!
Imzot, mos më lerë pa kave!

1. Myxhizatë: mrekullitë e profetëve.
2. Hyrmet: nder.
Fatimeja: e bija e profetit Muhamet.
3. Merjemja: Maria.
4. Mubareq: i uruar.
5. Meleq: engjëll.

6. Ismitë: emër.
Gafur: përdëllyes.
7. Meshhur: i famshëm.
8. Zade: i biri.

vijon në numrin e ardhshëm

Mediakafe Në një anketë të organizuar nga një OJQ që vepron në Berat për "Personin VIP të Media-2003", në vend të parë qëndron militantja e partisë që u shpreh në prani të mediave në takimin partiak në pallatin e kulturës se: "Nuk duam as të hamë, as të pimë, as të flemë, as të rrimë, as të vishemi, as të zhvishemi, vetëm shoku Nano dhe shoku Meta të mos zihen më."

Kjo thënie ka pushtuar gjithë median shqiptare si dikur thënia e famshme "Edhe bar do të hamë, po parimet nuk i shkelim!"

Kur i thanë një mësuesi dhe krijuesi të njohur në Berat, ish i burgosur politik në diktaturë, se që nderuar me titullin "Mësues i popullit", ai pa më të voglën përshtypje për lajmin që i dhanë u përgjigj : -Keni gabuar miqtë e mi! Unë e kam marrë njëherë këtë titull aty nga vitet shtatëdhjetë. Gjykatësi në fund të gjyqit u shpreh se unë deklarohej "Armik i popullit" dhe më pas shqiptoi edhe shpërblimin me 10 vjet burg.

Në takimin që zhvilloi lideri i një partie me intelektualët e qytetit, në një moment egzaltimi të folsit intelektual në foltore, dikush nga fundi i sallës nuk duroi dot e ia dha : Poshtë ...!

Miku i tij që i rrinte në krah i vuri dorën tek goja dhe i tha :
-Hesht, mor hajvan! Intelektualët nuk përdorin kurrë, as fjalën poshtë as fjalën rroftë.
Sot jemi këtu si intelektualë, jo si militantë!

Kryeministri Fatos Nano në vizitën e fundit në Berat shkoi edhe tek fabrika italiane e blankerive në Velabisht. Pas mbledhjes që zhvilloi me biznesmenët në një nga mjediset, në shenjë respekti mikpritësit i falën një pako me prodhime të asaj fabrike.

Kryeministri e refuzoi pakon me mirësjellje duke folur me zë të ulët:

- Po ju e dini që ne jemi çift i ri dhe hëpërhë prodhimet tuaja s'na hy

Konkurs i Artit Sakral

Rishfaqet pas 10-vjetësh në Berat Don Giuseppe Colavero, përsëri me të njëjtin qëllim, të organizojë çmimin “Anna Tobia Colavero” në artet vizive dhe në muzikë. Duke përjashtuar në këtë edicion poezinë. Edicioni i tretë i çmimit Anna Tobia Colavero në arte vizive u bë i mundur nga shoqata “Agimi” Berat dhe shoqata “Agimi” Maglie Itali. Në këtë organizim morën pjesë 16 artistë vizivë të Beratit me rreth 60 vepra të ekspozuara. Ajo që u vu re në krahasim me dy edicionet e kaluara ishte se pak artistë erdhën si krijues, ndërsa të tjerët thjesht si imitues ikonash etj. Artistët vizivë nuk e kishin vlerësuar siç duhet këtë konkurs edhe pse çmimet nuk ishin të këqinj (në aspektin monetar). Në ndryshim nga dy edicionet e mëparshme, këtë herë kishte një keqkuptim, pjesmarrësit nuk duhet të paraqisnin kopje ikonash. Ndërsa për fushën e muzikës, unë arrita të qëndroj vetëm tre katër minuta në atë konkurim, pasi nuk mund të rezistoj më tepër. Mendoj se të kujtdoqofshin këto lloj organizimesh, duhen të kenë si koncept bazë artin dhe jo drekat e darkat qesharake, që sapo vijnë e shtohen duke thëlluar më tepër distancën me Perëndimin. Në organizimet e viteve 1992 -1993 mund të kishte remineshenca nga e kaluara, por në një farë mënyre kishte klasë artistik. Këtu do të përmendja në artet vizive: Sotir Capo, Vangjel Papa, Arben Golemi, Gazmend Muka, Nexhmedin Musai, Agron Polovina etj. Në poezi : Balil Gjini, Yzedin Hima, Simon Vrusho, Agim Mehqemeja, Asllan Saraçi etj. Dhe në muzikë: Valentin Veizi, Dhimitër Dushi, Naim Veizi, Fatos Azizi, Floriart Luari. Në artin dramatik: Ilir Pipiria, Pranvera Lumani, Agron Ferro.

I përmenda këta emra për të treguar seriozitet në konkurim e jo si në këtë konkurs të këtij viti që morën pjesë fëmijë të qendrës kulturore.

Artet Vizive :

çmimi i parë: Bruno Ago,
çmimi i dytë: Agron
Polovina, çmimi i tretë:
Llambri Dëna.

Muzikë:

çmimi i parë: Altin Metohu,
çmimi i dytë: Avram Buda,
çmimi i tretë Naim Veizi.

Kastriot Dervishi, piktor

Pëlqesëza e një qyteti

Mund ta quaja edhe thjesht shije artistike, ose përzgjedhje midis atyre grupeve që bëjnë art, por

më pëlqeu ta quaja me një fjalëz pak si të padëgjuar, si të stisur enkas për këtë shkrim, pëlqesëz.

Kjo fjalëz nuk mbart ndonjë përqeshje as për artistët (më vraftë Zoti nëse më ka shkuar ndërmend një gjë e tillë!), as ka ndonjë kunjë me bashkëqytetarët e mi, që bëjnë përzgjedhjen, se kjo është një e drejtë që e kanë fituar me Kushtetutë, sipas pëlqesës që kanë e jo sipas planeve të drejtuesve të trupave artistike, që marrin mundimin të zbresin në Berat.

Po kjo fjalëz, megjithatë, e ka një kleçkëz fare të vockël, që dëshiroj ta them jo për bashkëqytetarët e mi, se për ata ky shpjegim nuk ka asnjë vlerë, por për ata, miqtë artistë, që marrin mundimin të vijnë dhe të ikin nga Berati.

Asnjë grup të mos bëj gabim të marrë rrugën për në qytetin e njëmbinjë dritareve pa mësuar më parë se cila është pëlqesëza e tij. Dhe që ta mësojë të vërtetën e kësaj pëlqesëze, para se të ngrihet me laçkë e me plaçkë, le të fusë më parë, fundja le ta kërkojë edhe brenda në qytet (kjo as na bën të na skuqet faqja), një nga ata që në gjuhën e popullit quhen “fuks”. Dhe, kur ky “fuks” t’ia ketë bërë të ditur këtë të uruar pëlqesëz, vetëm atëherë le të vendosë nëse duhet të zbresin ose jo në Berat.

Nuk është faji i beratasit, as mos t’i shkoj ndër mend një gjë e tillë, nëse do të largohet ashtu siç erdhi. Fajin le ta mbajë për vete. S’ka pse e merr mundimin pa e mësuar më parë të vërtetën e pëlqesëzës së tij.

Le të marrim si shembull atë që ngjau para pak ditësh.

Na zbret serbes - serbes në Berat trupa shumë e njohur e Teatrit Kombëtar. Sigurisht, nga qëllimi i mirë u nis. Këtë ne e dimë. Kjo as që vihet në dyshim. Deshi ta gjallëronte cazë jetën tonë të vakët artistike. Merret me mend, mirë e kishte menduar. Po ja që këtu nis dhe gabimi. Nuk u vlerësua apo më mirë të themi u harrua të mësohej që më parë e vërteta magjike e pëlqesëzës së tij të uruar. Le ta themi ashtu me zë paskëz të ulët, midis nesh, që të mos na dëgjojë, se na zemërohet dhe na braktis njëherë e mirë (dhe kë pa, më thuaj?!), qytetin tonë aq të njohur për mikpritjen dhe begenisjen (dhe të mos harrojmë që i ka ardhur dhuratë nga të parët dhe që e ruan me aq fanatizëm), që, në e marrtë sërish mundimin, të mos i ndodh t’i ngrëjë sërish rraquet, duke lënë të dëshpëruar të vetmin dashamirës që begenisi të hynte në sallën e shfaqjeve të pallatit të kulturës “Margarita Tutulani”!

Kjo trupë, edhe sikur pa para ta kishte dhënë shfaqjen e saj (të parë apo të paparë, kjo s’ka fare rëndësi), vetëm këtë dashamirë të teatrit do të kishte patur si spektator.

Ç’t’i bësh! Kështu janë gatuar beratasit! Nuk e duan atë që nuk përputhet me pëlqesëzën e tyre.

Ndryshe ndodh me konceritn që një trup këngëtarësh dhe humoristësh zbret nga Tirana. Më 9 korrik e patëm midis nesh një trupë të tillë. Dhe ajo arriti dhe e pushtoi stadiumin! Dhe e korri suksesin. Edhe pse këngët dhe humorit që sollti me vete nuk ishte i ri, i padëgjuar, ishte parë e ishte stërpërparë nëpër akranet televizive (njëlloj si “Pallati 176”).

Dhe beratasi as që deshi t'ia dinte, vajti dhe e pagoi 200 lekë biletën!

Kështu qenkerka thënë!

Faji nuk duhet kërkuar asgjilkundi. Le t'i mbetet vetëm kësaj fjalëze që desha dhe e quajta ashtu thjesht "pëlqesëz".

Agron Feriti

Një restaurim i ri

Skeda e veprës:

Titulli : Potreti i Heroinës Margarita
Tutulani

Autori: Sotir Capo -Artist i Merituar

Viti i realizimit 1961

Teknika : Vaj në kanavacë pambuku.

Gjendja : e mjerueshme.

Ky portret ka qenë ekspozuar deri në vitin 1992 në hollin e pallatit të kulturës. Vendosur keq nuk u vu re, kur një ditë u hoq. Në vitin 2001 punonjësit e panë në atë gjendje të keqe. Plotësisht i degraduar, i dëmtuar, grisur dhe shkelur kishte humbur vlerat.

Pak histori:

Është një nga porositë e para zyrtare të piktorit S. Capo, që sapo kishte filluar studimet në Konservatorin e Tiranës.

"Gjatë pushimeve, rrinim pranë pallatit si artistë që ishim. Ishte viti 1961 dhe këtij pallati, meqë do t'i vendosej emri i Margaritës, duhej portreti i saj në pikturë. Drejtor ka qenë Koli Salepi, ndërsa piktor një shkodran me emrin Guljem Mosi, por më zgjodhën mua. Kisha dëshirë për ta realizuar këtë portret, sepse, megjithëse i vogël, e kisha parë heroinën dhe më kishte mbetur në kujtesë. Portreti u pëlqye nga familja, sigurisht dhe nga zyrtarët. Megjithatë nuk më paguan".

Ky portret në krijimtarinë e S.Capos shënon tendencën për "angazhimin" në krijimtari megjithëse në të shfaqen elementë natyralist e romantik dhe të natyrshme për periudhën studimore të autorit.

Gjendja:

Piktura reflekton gjithashtu situatën e pakonsoliduar profesionale dhe gjendjen e mjerueshme materiale. Ajo është kryer në një telajo prej druri të improvizuar. Mbi kanavacën prej tekstil pambuku me një strukturë jo të përshtatshme është shtrirë një përgatitje e rëndomtë tutkalli organik dhe oksidi zinku të vendosur në dy shtresa të holla. Mbi këtë suport është realizuar me ngjyra vaji të markave të ndryshme të përgatitura me benzinë. Piktura është kryer në mënyrë të thjeshtë intuitive. Në hapësirën e sfondit, në veshjet dhe flokët, ngjyra është vendosur në formë velaturash të holla, ndërsa në portret në mënyrë pastoze. Gjendja në çastin e vendosjes mbi tavolinën e restaurimit ka qenë shumë e keqe. Telajua e drurit e thyer, e deformuar, me shenja të shumta dëmtimesh nga brejtësit, nuk ishte në gjendje të tendoste kanavacën. Kanavaca prej pambuku dhe e gruntuar rëndom ishte në gjendje mjaft të keqe. Prania e vazhdueshme e lagështirës kishte nxitur zhvillimin e myqeve dhe kalbëzimin e fibrave të tekstilit. Veprimet mekanike e kishin shqitur dhe deformuar, në disa vende edhe e kishin shqyer. Sidomos në mjekër. Si rezultat i një shtrese të mirë papastërtish, rrjedhjesh, pluhuri dhe mungesës së shtresës mbrojtëse të vermikut, piktura paraqitej e errësuar dhe vështirësisht e identifikueshme. Grundi që kishte humbur aftësinë lidhëse, paraqitej i shkëputur në disa sektorë dhe me humbje të shtresës piktorike sidomos në sfond dhe flokët. Restaurimi u përqëndrua në transferimin e saj në një suport të ri dhe të qëndrueshëm, qepjen e dëmtimeve të kanavacës në mënyrë që të shmangeshin tensionet e deformimet e më-vonshme të ndërhyrjes konsoliduese të grundit nëpërmjet kompresave të ngopura me xhelatinë. Pastrimi i sipërfaqes nga papastërtitë dhe mbivendosjet ishte një proces i vështirë. U realizuan me ndërhyrje mekanike dhe solucione të ndryshme tretësirash. Plotësimi i pjesëve të humbura të pikturës ritokimet në gamat ngjyrore dhe integrimet nëpërmjet velaturave rivlerësuan të gjithë veprën. Tani mund të lexohen lehtësisht mënyra dhe fryma në të cilën u realizua, duke rivlerësuar shijimin e plotë të imazhit.

Piktori Sotir Capo është një artist me krijimtari të gjatë të zhvilluar në Berat. Vetëm pas viteve 90-të ai emigron së pari në Athinë dhe më vonë në Amerikë, ku edhe jeton. Në këtë periudhë ai rrëfen se krijimtaria dhe kushtet në të cilat zhvillohej kanë qenë të vështira.

"Kam punuar va-zhdimisht, por jo i ngopur. Megjithë pengesat që kemi patur dhe nga mjedisi (mediokër, mbytës), që na rrethonte, mundëm që të rezistonim".

Ai mendon " ... se artisti duhet të jetë i sinqertë me veten, të hedhë në telajo ndjenjat e tij dhe të reflektojë kulturën profesionale."

Tani duke reflektuar mbi krijimtarinë e mëparshme dhe duke shijuar lirinë artistike, nënvizon "... se forma dhe stilet janë vetiake. Sot piktura është një shfaqje komplekse, duke pasur një karakter shoqëror ka dhe një të vërtetë artistike, ka stilin, klimën, ka dhe logjikën e vet".

Agron Polovina

Shënim: Citimet në thonjëza janë marrë nga letërkëmbimi i autorit me piktorin Sotir Capo.

Në Berat u shit vetëm një biletë teatri

Kohët e fundit erdhi nga Tirana në Berat për të dhënë shfaqje trupa e Teatrit Kombëtar me dramën "Ali Pashë Tepelena". Ndonëse shfaqja qe lajmëruar e reklamuar nëpërmjet afisheve, Tv-lokal, ditën e shfaqjes trupa priti gjer vonë në darkë dhe kur pa se nuk kishte asnjë shpresë, anuloi shfaqjen. Qe shitur vetëm një biletë. Në qytetin 2400 -vjeçar, ku sot jetojnë mbi 70.000 banorë jeton ende vetëm një dashmirës i teatrit.

Cfarë ka ngjarë ?

Mos vallë Berati është aq i varfër sa që banorët e tij të mos kenë të holla sa të blenë një biletë teatri njëherë në kaq kohë? Jo, sepse të rinjtë, të rejat, burrat mbushin kafenetë dhe lokalet plot e përplot gjatë gjithë ditës.

Atëherë çfarë ka ngjarë?

Miqtë e teatrit, spektaklit me ç' duket janë divorcuar njëherë e përgjithmonë me godinën e stilit sovjetik në mes të qytetit. Në këtë divorc përfundimtar një kontribut të madh kanë dhënë drejtuesit aktualë të institucioneve të kulturës dhe artit në qytetin e Beratit. Gjatë këtyre viteve, Qendra kulturore e Beratit , duke e konvertuar të gjithë veprimtarinë skenike në ca ahengje të neveritshme në raste festash tradicionale , ku evokohen ngjarje që s'kanë ndodhur fare në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, ahengje që nuk kanë të bëjnë as me muzikën qytetare të Beratit, as me këngët tradicionale të këtij qyteti, e kanë larguar, ftohur spektatorin e këtushëm. Aq indiferent është bërë ky spektator sa që nuk lexon as afisheet e ekspozuara pranë qendrës kulturore.

Cili qe ai "kalorës i artit" që preu biletën e vetme të teatrit në Berat? Ndoshta ndonjë njeri i vetmuar, pa miq, pa ... Sot, kur kanë kaluar disa ditë, të gjithë beratasit mund t'i thonë njeri-tjetrit se ai personi i biletës qe pikërisht ai, ose ajo. Të gjithë e kanë shansin për t'i thënë shokut se ende e konsiderojnë teatrin si një institucion mjaft të lartë, mjaft fisnik, institucionin më demokratik të qytetit. Veçse ajo që të trishton është se në Berat ka mbetur ende vetëm një, i fundmi spektator i teatrit. Po çfarë vjen pas ikjes së këtij "shtërgu"? Një dimër i gjatë, i ftohtë, i thatë. Të gjithë ikën, po ikin, do të ikin... përveç disa drejtuesve që vetëm me kulturën dhe artin nuk kanë të bëjnë. Ata janë aty edhe pas largimit të të fundmit spektator stoik të skenës. Janë aty, të paepur, qëndrestarë deri në fund... Në cilin fund?...

Gent Panariti

Foto arkiv nga Vlash Pambuku

Gjymnastikë Në vitin 1959, në shtëpinë e pionierit të qytetit, u ngrit edhe rrethi i akrobatëve. Trajnere ishte mësuesja e edukimit fizik Marjanthi Vjeshta. Në vitin 1960 ekipi del në vendin e tretë në kampionatin kombëtar të akrobatëve për kategorinë e parë. Në vitin 1961 ekipi vjen nga Tirana me kupën e kampionatit. Në këtë vit, në festën e "1 Majit", akrobatet, me kupën e kampionatit, marrin pjesë në parakalimin tradicional.

Në foto ekipi kampion: Lart: Marjanthi Vjeshta (trajnere), Tatjana Qirjako, Arta Rehovica, Hatixhe Caci (Tepelena).

Ulur: Meliha Çavolli, Polikseni Vjeshta (Gorishti), Liri Mahilaj.

Siç shihet, në këtë ekip marrin pjesë dy motra të familjes Vjeshta.

Basketboll Ka qenë sporti më me tradita . Tani ka mbetur i shuar. Në gazetën "Tomori", vite më parë, shkruhet :“ Në Berat u organizua kampionati lokal i basketbollit për vajza. Morën pjesë 4 ekiye të lagjeve: Goricë, Mangalem, Kala, Vakëf. Ekipet ishin pajisur me uniformë sportive. Takimi final midis Goricës dhe Vakëfit u ndoq edhe nga drejtues të sportit nga qendra. Kupën e fitoi ekipi i lagjes Vakëf. Tradita u thellua në vitet mbas Çlirimit . Në vitet 1950 vajzat beratase u renditën në kampionat në vendin e 5-të.

Në foto ekipi i "Tomorit" 1950: Liri Çipi, Minerva Roshi, Sanka Sollaku, Leonora Vrusho, Hatixhe Sollaku (kapitene).